



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:001595

Datë: 28.02.2020

Numri i dokumentit: 00865366

PS.nr.1/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE - DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË, Kryetari i Trupit Gjykses - Gjyqtari Valon Kurtaj, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arbnore Idrizi, në çështjen penale kundër të akuzuarës M.T. nga M., e akuzuar për veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit, sipas Aktakuzës PPS.nr.59/2017 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në prezencën Prokurores Speciale Merita Bina Rugova, të akuzuarës M.T. dhe mbrojtëses së saj Avokat A.G. nga P., me datë 27 janar 2020, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

M.T., me nofkën "U.A.", nga i ati F., ëma B. e vajzërisë C., e lindur më datë 5 dhjetor 1993 në fshatin S. të Komunës së M., me banim në M. në rrugën "M. T." ..., ka të kryer shkollën fillore, gjendjes së dobët materiale, amvise, e ve, nënë e një fëmije, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Me datën 20 qershor 2014, e akuzuara i është bashkangjitur të fejuarit të saj M.L., i cili nga muaji Shkurt 2014, ka qenë në Siri duke luftuar për organizatat terroriste ISIS, edhe pse e ka ditur se veprimi i tillë është i kundërligjshëm, e akuzuara përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, ka shkuar për në Stamboll dhe me aeroplan tjetër menjëherë ka vazhduar për në G., e pastaj nga aty me një automjet furgon ka kaluar në Siri, ku i është bashkangjitur organizatës terroriste ISIS dhe ka marrë pjesë në veprimtarin e kësaj organizate, me qëllimin që duke luftuar të detyrojnë Qeverinë Siriane, e pastaj edhe qeveritë e shteteve tjera, që të lënë pushtetin dhe të krijojnë Shtetin Islamik, në atë mënyrë që duke e përdorur shumën e rregullt mujore të të hollave nga Shteti Islamik i ka ofruar shërbime logjistike ushtarëve të ISIS, së pari të fejuarit të saj M.L., e pas vrasjes së të fejuarit M., bashkëshortit të dytë, sirianit të quajtur E., e pas vrasjes së të njëjtit edhe bashkëshortit të tretë L.S., të cilët aktivisht kanë luftuar në ISIS, ku gjithë kohën duke e ndërruar vendbanimin varësisht nga ndryshimi i territorit të Shtetit Islamik, deri sa ISIS-i, ka

pësuar disfatë të plotë ku ka qenë e detyruar që të dorëzohet te forcat Kurde, e cila pastaj me 24 maj 2019 me ndihmën e Ushtrisë Amerikane është depërtuar në Kosovë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit (05/L-002).

Gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 58, 59, 73, 74, 75, 83 dhe neni 3 paragrafi 3 të Ligjit për parandalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit (05/L-002), të akuzuarës i shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 3 (tre) vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Nëse e akuzuara gjatë kohës së verifikimit të dënimit me burgim me kusht kryen vepër të re penale, dënimi me burgim me kusht do të zëvendësohet me dënim me burgim, e në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe atë nga data 24 prill 2019 deri më 20 shtator 2019.

Në kuptim të nenit 58 dhe 59 të KPRK:

URDHËROHET e akuzuara të përmbushë detyrimin - vizitë te psikologu ose te këshilluesit tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre dhe atë në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës, të bëjë mbikëqyrjen e dënimit me burgim me kusht dhe detyrimit të shqiptuar ndaj të akuzuarës.

Në rast se e akuzuara nuk mban kontakte me Shërbimin Sprovues të Kosovës, ose nuk përmbush detyrimin - vizitë te psikologu ose te këshilluesit tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre, gjykata do ta revokoj dënimin me kusht, konform neni 55 të KPRK.

E akuzuara lirohet nga shpenzimet e kësaj procedure penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka parashtruar Aktakuzën PPS.nr.59/2017 të datës 06 janar 2020, kundër të akuzuarës M.T. nga M., e akuzuar për veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para-policore në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit.

Gjykata, duke vepruar sipas Aktakuzën PPS.nr.59/2017 të datës 06 janar 2020, ka caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor në të cilin shqyrtim e akuzuara M.T., ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, respektivisht veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë

ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para-policore në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë vendit.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale.

Gjykata gjendjen faktike në raport me veprën penale të përshkruar në aktin akuzues dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga e akuzuara, ku për shkak të pranimit të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes.

Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 257 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në konsultë të plotë me mbrojtësen e saj, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues e për të cilat e akuzuara ka qenë e njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i ka kundërshtuar por ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK, në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para-policore në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit, ku për këtë gjykata të akuzuarën e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, respektivisht shqiptimit të dënimit me burgim me kusht, gjykata në harmonim 73, 74, 75 të KPRK, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikimin në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, e ku si rrethana vendimtare të cilat kanë ndikuar në përcaktimi e dënimit janë:

- Pranimi i fajësisë nga e akuzuara për veprën penale për të cilën akuzohet. Ku pranimi i fajësisë është konsideruar si rrethanë tejet lehtësuese;
- Pendimi i saj i thellë për kryerjen e veprës penale, ku që nga faza e hershme e hetimeve (duke përfshirë edhe deklaratimet e saj në hetuesi) e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor, ka shprehur pendimin e saj për pjesëmarrjen në organizatë terroriste si dhe në luftimet në zonën e konfliktit Siri - Irak;
- Pjesëmarrja dhe roli i saj në grupet terroriste në të cilat ka qenë e inkuadruar ka qenë jo kyç, ku dhe nga vet akti akuzues e po ashtu edhe nga shkresat e lëndës shihet se e njëjta nuk ka pasur ndonjë rol kyç por vetëm se është inkuadruar në grupet terroriste, respektivisht në konfliktin e armatosur Siri - Irak dhe ku i ka shërbyer në aspektin logjistik fillimisht të fejuarit të saj, tani të ndjerit M. L., e pastaj edhe dy bashkëshortëve tjerë për të cilët ka qenë e martuar. Pra nuk ka pasuro ndonjë rol kyç në organizimin dhe funksionimin e organizatës terroriste ISIS, e as konfliktit të armatosur Siri - Irak, përpos mbështetjes logjistike të bashkëshortëve të saj. Ku me rastin e pësimit të disfatës së plotë

të ISIS, dorëzohet tek forcat Kurde, e më pastaj me ndihmën e ushtrisë Amerikane, kthehet në shtëpi në Republikën e Kosovës.

- Bashkëpunimi dhe sjellja e saj korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku një fakt të tillë e dëshmon edhe vet sinqeriteti dhe pranimi i fajësisë nga e akuzuara dhe vet fakti i propozimit të organit të akuzës që të njëjtës pranimi i fajësisë dhe sinqeriteti i saj, ti merren si rrethana posaçërisht lehtësuese;
- Gjendja e rëndë financiare e të akuzuarës, ku e njëjta është e pa punësuar dhe kujdeset për fëmijën e saj tre vjeçar. Marrë në konsideratë faktin se e akuzuara është e pa-punësuar dhe për përkujdesjen e saj kujdeset e ëma (familja e saj) dhe se ka një fëmijë të moshës 3 vjeçare, gjykata konsideron se çfarëdo lloj dënimi i shqiptuar tjetër nga ai që është shqiptuar me këtë aktgjykim, do ta rrezikonte mirëqenien e të akuzuarës e po ashtu dhe ekzistencën e fëmijës ë saj.
- Është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të dhënave që posedon kjo gjykatë, nuk rezulton se më herët ka pasur të kaluar kriminale apo ka kryer ndonjë veprë penale. Gjithashtu, me sjelljet e saja gjatë gjykimit, ka dhënë shenja të qarta se në të ardhmen do të jetë më e kujdesshme, nuk do bie ndesh me ligjin dhe nuk do të përsërisë ndonjë veprë penale, çoftë e llojit të kësaj për të cilën është shpallur fajtor apo ndonjë veprë tjetër penale.

Gjykata, në harmoni me nenin 58 e 59 të KPRK, të akuzuarës përpos dënimit me burgim me kusht i ka shqiptuar dhe detyrimin - vizitë te psikologu ose te këshilluesit tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre, e të cilat do të mbikëqyren nga Shërbimi Sprovues i Republikës së Kosovës.

E akuzuara në vetë deklaratimet e saj ka theksuar se ka pasur një gjendje të rëndë emocionale - shpirtërore për shkak të rrethanave jetësore në të cilat ka jetuar në zonën e konfliktit Siri - Irak, më pastaj dhe kushtet jetësore të rënda të cilat i ka përjetuar deri në momentin e kthimit në shtëpi gjatë qëndrimit nëpër kampe. Këto fakte përpos që e akuzuara i ka potencuar që në fillim të fazës së hetimit, që këto fakte të merren në konsideratë, ka kërkuar edhe mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku ka theksuar se e akuzuara ka nevojë për risocializim pas gjithë asaj që ka pësuar.

Marrë në konsideratë këto rrethana, gjykata konsideron se përpos dënimit me burgim me kusht, të akuzuarës ti shqiptohet edhe mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues dhe vizita e konsulta tek psikologu ose te këshilluesit tjerë. Mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues i dënimit me kusht dhe i detyrimit për kontakte me psikologun apo këshilluesit, të akuzuarës i është shqiptuar me qëllimin e vetëm të ri-integrimit të saj sa më të mirë në shoqëri, për faktin se e njëjta është penduar për veprimet e bëra në të kaluarën dhe se intenca kryesore e saj është ri-integrimi në shoqëri, ku mbikëqyrja e dënimit me kusht dhe konsulta te psikologu do të jenë mënyra më e mirë e integrimit në shoqëri.

Andaj duke u bazuar në të gjitha këto që u elaboruan, gjykata të akuzuarës i shqiptoi sanksionin penal dhe detyrimin, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se i

përgjigjen shkallës së përgjegjësive penale juridike të saj dhe se me këtë sanksion dhe detyrim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, që në të ardhmen e akuzuara të përmbahet nga veprimet e tilla dhe se të integrohet në shoqëri si një pjesëtar pozitiv i saj.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të neneve 450, 451 e 453 të KPPRK-së, ku të akuzuarën e liroi nga shpenzimet procedurale për faktin se e njëjta ka gjendje të rëndë ekonomike dhe se me detyrimin eventual të saj me pagesë të shpenzimeve procedurale, gjendja e saj ekonomike do të rëndohet edhe më shumë.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.1/2020 datë 27 janar 2020

Zyrtare Ligjore,
Arbnore Idrizi

Kryetari Trupit Gjykses,
Valon Kurtaj

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës Apelit - Departamenti Special në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore - Departamenti Special në Prishtinë.